



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-
KOMISIONI I KONKURENCËS**

Njoftim për mediat

“Për marrjen e masave të përkohshme për ndalimin e marrëveshjes në tregun e prodhimit dhe të tregtimit të bukës në qytetin e Vlorës”

Tiranë, 12 Prill 2011- Komisioni Konkurrencës ka vendosur marrjen e disa masave të përkohshme për ndalimin e marrëveshjes në tregun e prodhimit dhe të tregtimit të bukës në Qytetin e Vlorës pas raporteve të medias të datës 25 Mars 2011 ku informohej se çmimi i bukës në qytetin e Vlorës ka një rritje të menjëhershme dhe thajse nga të gjithë ofruesit.

Këto masa janë marrë në kuadër të hetimit që po kryen Autoriteti i Konkurrencës në këtë treg, me qëllim ndalimin e shkeljeve të mundshme të Ligjit 9121, “Për mbrojtjen e konkurrencës”. Autoriteti i Konkurrencës, në mënyrë të menjëhershme, ka realizuar inspektime në këtë treg, ku u konstatua se rritja e çmimit të bukës në qytetin e Vlorës ka ardhur pas një takimi të 42 prodhuesve dhe tregtuesve të bukës në datë 21.3.2011. Në këtë takim është rënë dakord se që nga data 23.03.2011 çmimi i bukës 900 gr do të jetë 120 lek dhe çmimi i bukës 450 gr. do të jetë 60 lek.

Ky njoftim është afishuar në të gjitha njësitë tregtare dhe prodhuese të bukës dhe çmimi i fiksuar nga inspektimet paraprake rezulton se është zbatuar nga të gjithë pjesëmarrësit në mbledhjen e datës 21.03.2011 sipas procesverbalit të administruar. Sjellja e këtyre ndërmarrjeve për fiksimin e çmimit të shitjes së bukës në qytetin e Vlorës ka të ngjarë të jetë një shkelje e nenit 4, pika 1, germa a) të Ligjit Nr 9121, dt 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar). Kjo shkelje e mundshme sjell një dëm të rëndë për konkurrencën në treg dhe për konsumatorët.

Për këto arsye Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të neneve 24, shkronja d, 44, pika 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”(i ndryshuar), për shkak të dëmit që mund t'i shkaktohet konsumatorëve të qytetit të Vlorës nga sjellja anti-konkurrese e 42 prodhuesve dhe tregtuesve të bukës, dhe meqenëse ka të ngjarë të ketë shkelje të nenit 4 të Ligjit, vendosi marrjen e masave të përkohshme sipas nenit 44, pika 1, si vijon:

- Pjesëmarrësit në marrëveshjen e ndaluar për rritjen dhe fiksimin e çmimit të bukës në qytetin e Vlorës, duhet t'i japin fund menjëherë sjelljes së bashkërenduar për fiksimin e çmimit të bukës.
- Masat e përkohshme duhet të zbatohen me marrjen në dijeni të këtij vendimi dhe do të zbatohen për një periudhë kohe deri në përfundim të hetimit.
- Moszbatimi i vendimit për masa të përkohshme ndëshkohet me gjobë deri në 10 % të xhiros vjetore për shkelje të rëndë të konkurrencës në zbatim të nenit 74, pika 1, germa b të Ligjit
- Në rast të moszbatimit të masave të përkohshme brenda afateve të përcaktuara në këtë vendim, në baze të nenit 76, pika b të Ligjit 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Komisioni i Konkurrencës mund të vendosë gjopa periodike deri në 5 % të xhiros mesatare ditore të vitin financiar para-ardhës, e cila llogaritet nga data e marrjes së këtij vendimi.

Duke marrë shkas nga këto ngjarje, Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të Politikës Kombëtare të Konkurrencës dhe Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”, kërkon të ndërgjegjësojë të gjithë organizatat e biznesit, formale apo jo formale, që në veprimtarinë e tyre të mbrojnë interesat e anëtarëve sipas ligjit dhe të mos ndikojnë në vendosjen e praktikave të bashkërenduara/të koordinuara për rritje të menjëhershme të çmimeve, fiksime çmimesh apo ndarje tregu.

Sqarojmë se në kuptim të nenit 3 pika 4 dhe nenit 4 të Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës” marrëveshjet e ndaluara janë shkelja më e rëndë dhe sjellja më anti-konkurrese dhe mund të ndëshkohet nga Komisioni i Konkurrencës me gjobë deri në 10 % të xhiros vjetore. Autoriteti i Konkurrencës fton edhe një herë shoqatat e biznesit për rritjen e bashkëpunimit në realizimin e misionit të tij për vendosjen dhe ruajtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg.

Për çdo ankesë, kërkesë për informacion apo kërkesë për bashkëpunim në zbulimin e ndonjë shkelje të ligjit të konkurrencës, jeni të lutur të vizitoni faqen tonë të internetit www.caa.gov.al, dërgoni email në competition@caa.gov.al, fax: +355 4 2234497, tel +355 4 2234504 ose të paraqiteni pranë Autoritetit të Konkurrencës në adresën rr. Sami Frashëri, nr.4, Kati IV, Tiranë.